

PARASHTRËSË
PËRPARA GJYKATËS KUSHTETUESE

Në lidhje me çështjen

Kërkues: 28 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë

Subjekte të Interesuara: Kuvendi i Shqipërisë
Olta Xhaçka, deputete e Kuvendit të Shqipërisë

Objekti:

1 Kundërshtimin e Vendimit Nr. 83/2022, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”, kundërshtimin e Vendimit Nr. 84/2022, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”

2. Konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka

E nderuar zonja Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Të nderuara anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

1. Me shkresën Nr. 790 Prot., datë 16.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, jemi njoftuar dhe kemi marrë dijeni mbi vendimin e kësaj Gjykate për të shqyrtuar në seancë plenare publike kërkesë e paraqitur nga 28 Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Po kështu me anë të këtij njoftimi kemi marrë dijeni edhe për përmbajtjen e kërkesës së paraqitur nga 28 Deputet e Kuvendit të Shqipërisë.

2. Në ushtrim të së drejtës sonë për të paraqitur argumenta mbi kërkimet e bëra nga 28 Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, po paraqesim përpara të nderuarës Gjykatë Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë parashtrimet përta më poshtë vijon.



3. 28 Deputetet e Kuvendit të Shqipërisë, me kërkesën e tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese kanë kërkuar që kjo Gjykatë të shprehet për sa më poshtë:

1 Kundërshtimin e Vendimit Nr. 83/2022, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”, kundërshtimin e Vendimit Nr. 84/2022, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”

2. Konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka

4. Kërkesa e parashtruar prej 1/5 së deputetëve të Kuvendit nuk gjehet e mbështetur si në depozitat kushtetuese që kërkesit i janë referuar, ashtu edhe në dispozitat e legjislacionit përkatës për sa i përket ekzistencës së papajtueshmërisë së mandatit të deputetit dhe qënies së saj në konfliktit interesi me mandatin e deputetit.

5. Kuvendi i Shqipërisë në seancën e datës 17 Nëntor 2022 ka miratuar me shumicë Vendimi Nr. 83 “Për mos miratimin e raportit të pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.” Po në këtë datë Kuvendi i Shqipërisë ka miratuara edhe vendimin Nr. 84 “Për miratimin e raportit të mazhorancës në Këshillin e Rregullores Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”

6. Këto vendime të Kuvendit të Shqipërisë janë marrë në procesin e shqyrtimit të një mocioni të paraqitur me datë 20.06.2022 nga 15 deputetë të Kuvendit, me anë të së cilit ata i kërkonin Kuvendit të vendoste për t’i dërguar në Gjykatë Kushtetuese kërkesën për deklarimin mbarimin/pavlefshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës së Shqipërisë.

7. Në vijim të procedurës parlamentare të parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, shqyrtimi i mocionit është bërë nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet. Për këtë qëllim nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet janë Zhvilluar 5 mbledhje.

8. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e mocionit Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, për shkak të mosdakortësisë ndërmjet anëtareve të tij, i ka paraqitur seancës plenare dy raporte në lidhje me çështjen e mbarimit/pavlefshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Nga deputetet pakicës në Komisionin e Rregullores, Mandateve dhe Imuniteteve është paraqitur raporti për dërgimin në Gjykatë Kushtetuese të kërkesës për deklarimin e mbarimit/pavlefshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Nga deputetët e mazhorancës është paraqitur raporti për



2

mosdërgimin në Gjykatë Kushtetuese të kërkesës për deklarimin e mbarimit/pavlefshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka.

10. Të dy raportet e mësipërme i janë paraqitur Kuvendit të Shqipërisë, i cili në seancën plenare të datës 17.11.2022 me Vendimin e tij Nr. 83 ka vendosur të mosmiratojë e raportin e pakicës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa me Vendimin Nr. 84 të po të njëjtës datë ka vendosur të miratojë e raportin e mazhorancës në Këshillin e Rregullores, Mandatave dhe Imunitetit për kërkesën mbi ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka, të Kuvendit të Shqipërisë.”

11. Të dy vendimet si ai me Nr. 83 dhe Vendimi Nr. 84 i Kuvendit të Shqipërisë janë vendime të drejta e të marra në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi, përse i përket ekzistencës së faktit të parashikuar nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për deputeten znj. Olta Xhaçka.

LEGJTIMITETI I KËRKUESIT

12. Kërkesa e paraqitur nga 14 deputete e Kuvendit të Shqipërisë nuk duet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese për shkak se kërkimi tyre është paraqitur në këtë Gjykatë jashtë afatit kohor, si dhe për faktin se 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë nuk përbën subjekt kushtetues.

Afati i paraqitjes së kërkesës.

13. Sikurse rezulton nga përmbajtja e kërkesës së paraqitur nga 1/5 e deputetëve përpara Gjykatës Kushtetuese, kërkimi i tyre shtrihet për vendimmarrjen e Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me mocionet e paraqitura përpara tij për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Në themel ky gjykim ka të bëjë me papajtueshmërinë e mandatarit të deputetit sipas parashikimeve të pikës 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

14. Kërkimi për deklarimin si të papajtueshëm të mandatit të deputeti, për shkak se ai është ushtruar në kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës është një kërkim, i cili nuk mund të ngrihet në çdo kohë përpara Gjykatës Kushtetuese, por sipas ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” janë përcaktuar edhe afate kohore për paraqitjen e këtij kërkimi për të venë në lëvizje këtë Gjykatë.

15. Sipas nenit 66/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar parashikohet se:

1. Kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve paraqitet në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.

2. Kërkesa për papajtueshmëri të funksionit të deputetit mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, por jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se 3 muaj nga konstatimi i papajtueshmërisë.

3. Gjykata Kushtetuese në këto raste përfundon shqyrtimin e çështjes brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

16. Sipas pikës 2 të këtij neni parashikohet se kërkesa për papajtueshmërinë e mandati të deputetit ngrihet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit dhe jo më vonë se 3muaj nga data e konstatimit të papajtueshmërisë. Këto afate sipas parashikimeve ligjore janë afate prekluzive, që nënkuptojnë se kërkitimi për papajtueshmëri funksioni duhet të ngrihet jo më vonë se 6 muaj nga data e përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se 3 muaj nga konstatimi papajtueshmërisë.

17. Kërkimi për përfundimin e mandatit të deputetes znj Olta Xhaçka pretendohet në përmbajtjen e kërkesës së paraqitur nga 1/5 e deputetëve, se është rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarisë fitimprurëse nga ana e shoqërisë AG TCC shpk nëpërmjet marrjes së statusit *investitor strategjik, procedurë e asistuar* dhe për faktin se shoqëria AG TCC Management Hotel shpk, ka përfituar nëpërmjet VKM 137, datë 02.03.2022 të drjtën e përdorimit të brigjeve të detit dhe për një periudhë 30 vjeçare, sipas kontratës që do të lidhet me Bashkinë Himarë për këtë qëllim. Pa i hyrë shkakut substancial, nëse ekziston apo jo kushtet që pasjellin papajtueshmërinë e mandati, duhej që kërkitimi për këtë papajtueshmëri të ngrihej përpara Gjykatës Kushtetuese brenda periudhave të parashikuara nga neni 66/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” të ndryshuar.

18. Rezulton e provuar, sikurse shprehen edhe në kërkesën e tyre 1/5 e deputetëve, se ata i janë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me mocion me datë 01.07.2022 për të kërkuara nga Kuvendi që t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në kuptim të pikave 3 dhe 4 të Kushtetutës për të zgjidhur çështjen e pretenduar prej tyre për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Nëse do të mbajmë në konsideratë afatet e përcaktuar nga ligji, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje për të shqyrtuar kërkesën kur ajo është paraqitur brenda afatit. Nisur nga fakti se ligji kërkon një afate kohor për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese dhe kur ligji e lidh këtë afat me momentin e konstatimit të papajtueshmërisë, llogaritja e këtij afati do të bëhet nga data se kur kërkesit janë vënë në dijeni të shkakut, që sipas pretendimit të tyre sjell për pasojë papajtueshmërinë e mandatit të deputetit sipas parashikimit të pikës 3 të Kushtetutës.

19. Rezulton e provuar se fakti i fitimit të *statusit investitor strategjik, procedurë e asistuar* prej shoqërisë AG TCC shpk dhe i fitimit nga shoqëria AG TCC Management Hotel shpk sipas VKM 137, datë 02.03.2022 i të drejtës së përdorimit të brigjeve të detit, janë bërë të njohura botërisht me datë 02.03.2022. Sipas provave që kemi bashkangjitur këtyre parashtrimeve rezulton se me datë 02.03.2022 BIRN (gazetari investigative) ka publikuar faktin e përfitimit nga shoqëria AG TCC shpk e statusit *investitor strategjik, procedurë e asistuar* dhe të faktit së Këshilli i Ministrave kishte dhënë të drejtën shoqërisë AG TCC Management Hotel shpk të përdorte brigjet e detit për një periudhë kohe 30 vjeçare. Po kështu, me datë 09.03.2022 është botuar në Fletorin Zyrtare, nr.

37 Vendimi nr. 137, date 02.03.2022 i Këshillit të Ministrave “Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues “Dreamades Luxury Suites””. Po kështu, vetë njëri prej nënshkruesve të kërkesës për këtë gjykim në Gjykatën Kushtetuese dhe po ashtu edhe të mocionit në Kuvendin e Shqipërisë deputeti Agron Shehaj, ka publikuar në facebook etij shkeljen e pretenduar nga deputetja znj. Olta Xhaçka për marrjen nga ana e shoqërisë në pronësi të bashkëshorti të saj të *statusit investor strategjik, procedurë e asistuar* dhe njëkohësisht edhe të së drejtës së përdorimit të brigjeve të detit që janë pronë publike.

20. Të gjitha provat e mësipërme pohojnë faktin se nga ana e 1/5 së deputetëve që kanë paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të kenë konstatuar të paktën që me datë 09.03.2022 faktin/shkakun antikushtetues që sipas pretendimeve të tyre sjell për pasojë pavlefshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Në frymën e ligjit “Për organizimin dhe funksionim e Gjykatës Kushtetuese”, kërkim për këtë shkak duhet të ushtrohej maksimalisht deri me datë 09.06.2022, duke filluar llogaritja e këtij afati që nga data e publikimit në Fletorin Zyrtarë të VKM 137, datë 02.03.2022, me anë të së cilit i është dhënë e drejta e përdorimit të brigjeve të detit. **Botimi i akteve normative në Fletoren Zyrtarë, përbën faktin se akti tashmë prezumohet se është i njohur nga të gjithë, përfshirë këtu jo vetëm njohje mbi dispozitat normative që ai ka vendosur, por edhe një njohje mbi faktet që përmban akti në brendësinë e tij, apo rrethit të subjekteve të cilit ai i drejtohet.** Mos paraqitja e kërkesës si përpara Gjykatës Kushtetuese brenda këtij afati, sjell për pasojë që kjo kërkesë të mos shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese për shkak të rënies në dekadencë së të drejtës së kërkuësve. Paraqitja e nj mocioni përpara Kuvendit me datë 22.06.2022 të mocionit për të kërkuar prej tij që në bazë të nenit 70, pika 3 dhe 4 të Kushtetutës t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nuk vë në vend të drejtën e humbur për shkak të rënies së saj në Dekadencë, pasi edhe mocioni është paraqitur tej afatit të parashikuar nga neni 66/a i Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar.

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese

21. Me kërkimin parë nga ana e 1/5 së deputetëve është kundërshtuar përpara Gjykatës Kushtetuese dy akte të Kuvendit, të cilët për nga përmbajtja e tyre janë akte të karakterit individual. Këto akte kanë këtë karakteristikë pasi në to është shprehur vullneti i Kuvendit si një organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, dhe që i drejtohet njërit prej subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës. Duke qënë me këtë qëllim, gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion të shqyrtojë kundërshtimin kundrejt një akti të natyrës individuale. Sipas nenit 124 të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Në këtë sferë të juridiksionit të saj nuk përfshihet gjykimi i akteve të karakterit individual.

22. Kërkuesi, një e pesta e deputetëve të Kuvendit, sipas kërkesës së depozituar në Gjykatën Kushtetuese, përveç kërimit për kundërshtimin e Vendimit nr. 83/2022, datë 17.11.2022 dhe Vendimit Nr. 84/2022, datë 17.11.2022 të Kuvendit të Shqipërisë, ata kanë kërkuar nga Gjykata

Kushtetuese, që kjo e fundit të shprehet edhe për papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka. Në këtë kërkim të tyre 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar pavlefshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka si pasoje e parashikimeve të pikës 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

23. Shkronja “e” e nenit 131 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se:

Gjykata Kushtetuese vendos për:

[...]

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;

24. Neni 134, pika 1, shkronja “c” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se:

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

[...]

c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;

25. Neni 70, pika 4 i Kushtetutës parashikon se:

4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

26. Kushtetuta ka njohur dy mekanizma për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues në të tilla raste, njëri bazuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse tjetri bazuar në nenet 131/e dhe 134/1/c të Kushtetutës. Sipas kërkesit, duke qenë se pretendohet se Kuvendi ka abuzuar me mekanizmin e parë, është detyrë e tij të kërkojë zbatimin e mekanizmit të dytë, duke iu drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për ushtrimin e juridiksionit të saj në përputhje me nenin 70/4 të Kushtetutës.

27. Në këtë kuptim na rezulton se për sa kohë Gjykata nuk është vënë në lëvizje në përputhje me parashikimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kërkesit i mungon legjitimiteti për të iniciuar gjykimin e konstatimit të pavlefshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka.

28. Si një nga subjektet e pakushtëzuara, 1/5 e deputetëve legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, pa pasur nevojën e justifikimit të interesit të tij (*shih vendimin nr.19, datë 15.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluara, por duhen parë në harmoni me

normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin, se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes.

29. Me vendimin e saj nr. 7, datë 24.02.2016 Gjykata Kushtetuese shprehet:

10. Sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Kurse sipas pikës 4 të po këtij neni: "Për çdo shkëlqe të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.". Në këtë dispozitë është përcaktuar Kuvendi si subjekt i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues, si dhe subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij). Përmbajtja e nenit 70/4 të Kushtetutës reflektohet edhe në nenin 66/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", sipas të cilit kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatë nga Kuvendi për sa kohë vazhdon mandati i deputetit. Vendimmarrja e Kuvendit, në kuptim të nenit 70/4 të Kushtetutës, është në funksion të legjitimitetit të këtij subjekti për iniciimin e gjykimit kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (shih vendimin nr.29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në kushtet kur dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës është norma e posaçme që rregullon procedurën për iniciimin e këtij lloj gjykimi, ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës. Gjykata vëren se ky është edhe interpretimi që vetë kërkuesi u ka bërë këtyre dispozitave kushtetuese, pasi siç dhe rezulton nga materialet e kërkesës ai nuk i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, por ka ndjekur rrugën parlamentare, duke i kërkuar Kuvendit që ta dërgojë çështjen në këtë Gjykatë.

12. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, një e pesta e deputetëve, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk legjitimohet t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit. Në të tilla raste, në pajtim me pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit."

30. Në interpretimin që Gjykata Kushtetuese i ka bërë të drejtës së 1/5 së anëtarëve të Kuvendit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, rezulton se 1/5 e deputetëve nuk t'i drejtohet direkt në Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar zhvillimin e një gjykimi për konstatimin e pavlefshmërisë së mandatit të një deputeti sipas parashikimeve të pikës 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës dhe në

këto kushte kjo Gjykatë nuk juridiksion për të zhvilluar një gjykim të tillë. Një e drejtë e tillë ju është njohur 1/5 së deputetëve nëpërmjet nenit 66 të ligji 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, te ndryshuar, ka të bëjë me rastet e tjera të papajtueshmërisë së mandatit dhe që nuk i përkasin rasteve të parashikuara nga neni 70, pika 3 dhe 4 e Kushtetutës.

RRETHANAT E FAKTIT

31. Nga 1/5 e deputetëve, të cilët kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar prej saj kundërshtimin e vendimeve Nr. 83 dhe 84, datë 17.11.2022 të Kuvendit të Shqipërisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhçka, *pretendohet se shoqëria AG TCC shpk në pronësi të bashkëshortit të deputetes, ka kryer veprimtari fitimprurëse me organet e pushtetit qendror dhe vendor si dhe pretendohet se kjo shoqëri ka përfituar pasuri prej këtyre të fundit.*

32. Zt. Artan Gaci, bashkëshorti i deputetes znj. Olta Xhçka, në kohën e paraqitjes së mocionit në Kuvendin e Shqipërisë ka qenë zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë AG TCC shpk. Kjo shoqëri sipas ekstraktit të regjistrimit në QKB ka për objekt të veprimtarisë së saj: *Aktivitet import-eksport, sipërmarrje, investime ne hoteleri turizëm, gastronomi si dhe çdo lloj sektori tjetër, veprimtari ne fushën e ndërtimeve, rikonstruksioneve, restaurimeve, konsulentë në fusha të ndryshme, ndërmjetësime ndërmjet shoqërive shqiptare dhe të huaja, etje..*

33. Me Vendimin nr. 5, datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) kësaj shoqërie i është miratuar Leja e Zhvillimit për ndërtimin e një strukture hoteliere në fshatin Gjilekë, Bashkia Himarë.

34. Me vendimin nr. 21. Datë 28.07.2020 të KKT shoqërisë AG TCC shpk i është miratuar Leja e Ndërtimit për objektin: “Resort turistik “Dreamades Luxury Sutes”, 1-2.3 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje fshati Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria AG TCC shpk.”

35. **E gjithjhe sipërfaqja e truallit prej 10.592 m² ku do të zhvillohet projekti për ngritjen e strukturës turistike, është 100% në pronësi, dhe me të drejta zhvillimi të shoqërisë investuese AG TCC shpk.** Shoqëria AG TCC shpk këtë pronë nuk e ka fituar nga asnjë subjekt qoftë ky organ i pushtetit vendor apo qendror por e ka fituar me anë të kontratave nga subjekte privatë.

36. Me vendimin 3/5, datë 29.03.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES” me subjekt AG TCC me NUIS L52227046H”, kësaj shoqërie i është miratuar ky status.

37. Me vendimin Nr. 3/9, datë 15.07.2021 të KIS “Për një ndryshim në Vendimin 3/5, datë 29.03.2021 të KIS “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”

për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES” me subjekt AG TCC me NUIS L52227046H,” statusi i investitorit Strategjik i jepet shoqërisë AG TCC HOTEL MANAGEMENT shpk. Shoqëria AG TCC Hotel Management shpk, sipas ekstrakti të regjistrimit rezulton se është një shoqëri ku kuotat e kapitalit të saj zotërohen në masën 100% nga Taëni Lin Grzych-Sutton.

38. Me Vendim Nr. 137, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Dreamades Luxury Suites”. Sipas këtij vendimi parashikohet se:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Dreamades Luxury Suites”, Gjilekë, Himarë, i cili me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, ka përfituar statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”.

2. Afati për përdorimin e brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas këtij vendimi, të jetë 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “AGTTC Hotel Management” sh.p.k, me NUIS M11825022K, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet e destinacionin e kërkuar nga subjekti, të lejuara me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, të ndryshuar, dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë.

39. Në kuptim sa më sipër sipas fakteve **nuk rezulton e provuar se shoqëria AG TCC shpk** (e cila në kohën e paraqitjes së mocionit përpara Kuvendit zotërohej 100% nga bashkëshorti i deputetes znj. Olta Xhaçka) **të ketë ushtruar në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës ndonjë veprimtari fitimprurëse me organet e pushtetit qëndror dhe vendor. Po kështu, nuk rezulton e provuar të jetë fituar as ndonjë pasuri prej tyre prej vetë deputetes znj. Olta Xhaçka ashtu dhe prej shoqërisë AG TCC shpk, ku në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve kuotat e saj zotëroheshin nga zt. Artan Gaci bashkëshort i deputetes znj. Olta Xhaçka.**

ARSYETIMI LIGJOR

40. Sipas përmbajtjes së kërkesës së paraqitur nga 1/5 e deputetëve pretendohet, se Kuvendi i Shqipërisë në nxjerrjen e Vendimeve të tij Nr. 83/2022 dhe 84/2022 të datës 17.11.2022 ka vepruar në kundërshtim me interpretimet e Kushtetutës të dala nga Gjykata Kushtetuese dhe po kështu njëkohësisht kërkon që gjykata të konstatojë të pavlefshmërinë e mandatin e deputetes znj. Olta




Xhaçka, pasi nga bashkëshorti i saj është duke u ushtruar veprimtari fitimprurëse me pasuri të shtetit nëpërmjet shoqërisë tregtare “AG TCC” shpk. Si ushtrim veprimtarie fitimprurëse sipas kërkesës konsiderohet, se është marrja e statusit *investitor strategjik/procedurë e asistuar* nga shoqëria AG TCC shpk. Po kështu, sipas kërkesës pretendohet se në kohën e marrjes së statusit “*investitor strategjik, procedurë e asistuar*”, kuotat e kapitalit të shoqërisë AG TCC shpk zotëroheshin nga z. Artan Gaçi, bashkëshort i deputetes znj. Olta Xhaçka. Këto veprime sipas kërkesve pretendohet se bien ndesh me parashikimet pikës 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës dhe për këtë shkak prej tyre është kërkuar që Gjykata Kushtetuese të konstatojë pavlefshmërinë dhe mbarimi i mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka.

41. Vendimet nr. 83/2022 dhe 84/2022 të datës 17.11.2022 të Kuvendit të Shqipërisë janë vendime të ligjshme dhe të marra në përputhje me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe me vetë praktikën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese. Rregullorja e Kuvendit në nenin 119/1 të saj parashikon në mënyrë të detajuar procedurën që ndiqet nga ana e Kuvendit për konstatimin e kufizimeve. Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet bën verifikimin nëse mocioni i paraqitur ndaj një deputeti të cilit, i kërkohet t'i ndërpritet mandati për shkaqet e parashikuara në nenin 70, pika 3 e Kushtetutës, *plotëson kërkesat juridiko-formale, siç (i) janë numri i anëtarëve nënshkrues, (ii) ekzistenca e dokumentacionit dhe provave që mbështesin mocionin e paraqitur, (iii) verifikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, (iv) verifikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si dhe (v) kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së tij.*

42. Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës, në to parashikohet për rastin, se kur Kuvendi i kërkon Gjykatës Kushtetuese të shprehet për pavlefshmërinë apo mbarimin e mandatit të një deputeti. Sipas këtyre pikave parashikohet, se Kuvendi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese **vetëm në ato raste kur pretendohet për papajtueshmëri të mandatin si pasojë e shkeljeve vetëm të paragrafit 3 të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse ai vetë kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre organeve.**

43. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutëbërësi ka parashikuar sipas paragrafit 4 të nenit 70, vënien në lëvizje nga Kuvendi i Shqipërisë i Gjykatës Kushtetuese, e cila në raste të tilla është organi që ka juridiksionin dhe kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen. E drejta e Kuvendit për të kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë/mbarimit të mandatit të deputetit nuk është e një e drejtë palimituar. Vetëm për çdo shkelje, të pretenduar se është kryer në kundërshtim me parashikimet e paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi ka të drejtë të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.



44. Në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, deputeti nuk mund të kryejnë ndonjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Gjykata Kushtetuese më vendimin e saj nr. 32, datë 03.06.2016 shprehet se *“Nëse deputeti përveç pagës që do të merrte si i tillë, do të mund të merrte edhe të ardhura të tjera nga buxheti i shtetit për shkak të profesionit të tij primar, atëherë ky parim do të cenohej. Kjo i shërben parimit të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve dhe parimit të demokracisë, ku çdo funksionar publik duhet të ushtrojë me të gjitha forcat dhe energjitë e veta detyrën për të cilën është zgjedhur ose emëruar, detyrë të cilën ai e ka pranuar me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë.”¹*

45. Pra, vetë deputeti nuk duhet të ketë apo ushtrojë ndonjë lloj veprimtarie fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre të fundit. Pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës është e qartë. Nisur nga përmbajtja e pikave 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me Vendim nr. 93 datë 17.05.2016 (vendim ky për shpalljen e moskompetencës së Gjykatës Kushtetuese për pavlefshmërinë/mbarimin e mandatit të një deputeteje) është shprehur se, **sipas pikës 3 të Kushtetutës, që Kuvendi të kërkojë pavlefshmërinë apo mbarimin e mandatit të deputetit duhet që shkelja e pikës 3 të nenit 70 të jetë kryer nga vetë deputetit dhe jo personat e lidhur me të.**

46. Shoqëria AG TCC shpk, nuk ka kryer asnjë veprimtari fitimprurëse me organet e pushtetit vendor dhe qëndror si dhe nuk ka fituar asnjë pasuri prej tyre. sipas Ligjit 55/2015 “Për investimet strategjike” statusi *investitor strategjik, procedurë e asistuar* nënkupton **procedurën administrative, me të cilën administrata publike ndjek, koordinon, asiston, mbikëqyr dhe, sipas rastit, përfaqëson investimin strategjik përgjatë fazave të zbatimit të tij. Vetë kjo procedurë nuk nënkupton ushtrimin e ndonjë veprimtarie fitimprurëse me organet e pushtetit qëndror dhe vendor, por vetëm asistencë administrative gjatë fazave të zhvillimit të projektit, asistencë kjo në kuptim e mbikëqyrjes dhe ndihmës në kryerjen procedurave të ndryshme administrative gjatë fazave të zhvillimit të projektit.**

47. Projekti Dreamades Luxury Suites, është në projekt që investohet tërësisht me financim privat dhe tërësisht në pronësi të shoqërisë AG TCC shpk. **Subjekti që ka marrë të drejtën e përdorimit të plazhit përpara strukturës hotelier sipas VKM Nr. 137, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave nuk rezulton të jetë shoqëria AG TCC, e cila është në pronësi zt. Artan Gaci, bashkëshort i deputetes Znj. Olta Xhaçka.** Subjekti i cili sipas VKM 137, datë 02.03.2022 ka marrë të drejtën e lidhjes së kontratës për përdorimin plazhit është shoqëria AG TCC Managment Hotel, subjekt tregtar ky që nuk është as në pronësi të deputetes Znj. Olta Xhaçka dhe as në pronësi të bashkëshortit të saj.

48. Trajtimi i një subjekti, apo investimi si strategjik është në çështje e rregulluar me ligj të posaçëm. Në vitin 2015 është miratuar ligji nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të krijoj kushtet e favorshme dhe lehtësuese për

¹ Vendimi 32, datë 03.06.2016 i Gjykatës Kushtetuese, fq. 9

investitorët që investojnë në sektorët e përcaktuar si strategjikë për ekonominë shqiptare. Statusi nuk nënkupton sipas ligjit në asnjë rast kryerje veprimtarie me fonde publike.

49. Është pikërisht ky ligj, i cili përcakton, se cilat janë kriteret, që duhet të plotësohen nga një subjekt, me qëllim që ky i fundit të marrë *statusin e investitorit strategjik*. Sipas parimeve të shpallur nga ky ligj, të konsideruarit të një investimi si strategjik është i lidhur ngushtë me faktin e përputhshmërisë së investimit që do të kryhet dhe interesit publik që realizohet nëpërmjet tij. Theksojmë se ky statusit **sipas ligjit nuk konsiderohet ushtrim veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as fitim i ndonjë pasurie nga këto organe**, gjë e cila të pasjellë si pasojë krijimin e një marrëdhënieje juridike në papajtueshmëri me funksionin e deputetit apo në konflikt interesi me të.

50. Subjektet që investojnë në turizëm nëpërmjet ngritjes së strukturave turistike, kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar statusin e investitorit strategjik. Por, edhe në këtë rast **ligji përsëri në mënyrë shteruese ka përcaktuar, se cili investim në sektorin e turizmit merr statusin e investitorit strategjik**. Pra, edhe në këtë rast ligji nuk i ka lënë shteg interpretimeve subjektive për të konsideruar apo më mirë të themi dhënien një subjekti statusin e investitorit strategjik.

51. Sipas pikës 3, shkronja “c)” e nenit 8 të ligjit nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” **ligji nuk e lidh dhënien e këtij statusi me pronësinë mbi subjektin që do të kryejë investimin sikurse pretendohet nga kërkuesit. Statusin e investitorit strategjik në sektorin e turizmit, sipas nenit të sipërcituar, e merr ai subjekt që plotëson njëherazi dy kriteret që kanë të bëjnë (i) me vlerën e investimit dhe (ii) vendeve të reja të punës që hapen për shkak të këtij investimi**. Në dhënien e këtij statusi KIS (Komisioni i Investimeve Strategjike), mbështetur në kriteret të qartë ligjore si më sipër, dhe jo në interpretime subjektive, ka konkluduar me vendimin e tij Nr. 3/5, datë 29.03.2021 t’i japë shoqërisë “AG TCC” shpk. statusin e investitorit strategjik, procedurë e asistuar në sektorin e turizmit.

52. Sipas ligjit 55/2015 “Për investimet strategjike”, me procedurë të asistuar kupton ato procedura administrative të parashikuar në këtë ligj, me të cilën administrata publike ndjek, koordinon, asiston, mbikëqyr dhe, sipas rastit, përfaqëson investimin strategjik përgjatë fazave të zbatimit të tij, megjithëse pjesa më e madhe e tyre janë marrë para fitimit të statusit. Në këtë kuptim qartazi **dhënia e këtij statusi nuk ka të bëjë as me ushtrim veprimtarie fitimprurëse me fonde publike dhe as marrje në pronësi apo përdorim të pasurive publike**.

53. Statusi *investitor strategjik, procedure e asistuar* është dhënë për projektin “DREAMADES LUXURY SUITES”, për shkak të kryerjes së investimit për ngritjen e një strukturë turistike, me vendndodhje në fshatin Gjilekë, Bashkia Himarë në një sipërfaqe totale prej 10,592 m². **Prona, ku do të zhvillohet projekti për ngritjen e strukturës turistike, është 100% në pronësi private**, dhe me të drejta zhvillimi të shoqërisë investuese AG TCC shpk. Ky projekt plotëson të gjithë kriteret e parashtruar në ligjin për Investimet Strategjike për përfitimin e statusit Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë, duke përfshirë të dhënat e mëposhtme:



54. Pra, sa më sipër është e qartë situata, **se investimi është konsideruar strategjik, vetëm për shkak se subjekti kërkues ka plotësuar kërkesat e dhëna në mënyrë shteruese nga ligji**, sikurse i sqaruar më sipër, dhe në asnjë rast ky status nuk lidhet me pronësinë mbi kapitalin e subjektit që kryhen këtë investim.

55. Por, edhe nëse i referohemi ligjeve të posaçme që rregullojnë konfliktin e interesit, përsëri ato nuk ndalojnë familjaret e funksionale të lartë shtetërore të kryejnë veprimtari private, përfshirë këtu edhe investimet në sektorin e turizmit në ngritjen e strukturave turistike, apo edhe në trajtimin si investitor strategjik për shkak të plotësimit të kriterëve ligjore. Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” nuk ndalon personat e lidhur me deputetin të ushtrojnë veprimtari private, por i kufizon ata në interesin privat.

56. Sipas interpretimit, që vetë Gjykata Kushtetuese i ka bërë pikave 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës, nisja e procedurës për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me ato raste, **kur vetë deputeti nëpërmjet veprimeve të tija aktive ka shkelur këtë ndalim kushtetues**, duke ushtruar ai vetë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor apo të ketë fituar pasuri prej këtyre të fundit. *Ndërsa sipas paragrafit 2 të nenit 70, Kushtetuta jonë ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite, kushtetutëbërësi ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit.*²

57. Pavlefshmëria/mbarim mandati sipas kërkesës i referohet më tepër parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës, për shkak se shoqëria në pronësi të bashkëshortit të deputetes ka marrë statusin e investitorit strategjik në turizëm dhe po kështu për shkak të dhënies së të drejtës për përdorimin e bregut të detit. Rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe për rrjedhojë Kuvendi nuk mund të kërkojë për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese për këto raste. Sipas provave, rezulton se deputetja znj. Olta Xhaçka ashtu edhe bashkëshorti i saj apo shoqëria AG TCC shpk që është në pronësi të bashkëshortit të saj nuk kanë përfituar asnjë pasuri të shtetit apo të pushtetit vendor gjatë gjithë kohës që ajo ka një mandat të vlefshëm deputeti.

58. Verifikimi nëse deputeti i Kuvendit është në kushtet nenit 70, pika 3 e Kushtetutës është kompetencë formale e Kuvendit, dhe ky i fundit nëpërmjet Këshilli për Rregulloren, Mandateve dhe Imunitetet duhet ta shqyrtojë nëse mocioni i paraqitur plotëson kushtet formale të kërkuar para se të vendosë për ta dërguar çështjen në Gjykatë Kushtetuese.

59. Me vendimin Nr. 7 datë 24.02.2016 Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

² Vendim nr. 7 datë 24.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese

“...përmbajtja e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk e ka zhveshur tërësisht Kuvendin nga vendimmarrja, por i ka kufizuar hapësirën e vlerësimit, duke ia njohur atë vetëm për verifikimin e kriterëve juridiko-formale për inicimin e procesit.

*Në të tilla raste Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, verifikon nëse mocioni i paraqitur plotëson kërkesat juridiko-formale, siç janë numri i anëtarëve nënshkrues, ekzistenca e dokumentacionit dhe provave që mbështesin mocionin e paraqitur, verifikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, **verifikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese**, si dhe kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së tij.”³*

60. Ajo që kërkohet nga Kuvendi nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet është verifikimi nëse mocioni paraqitur plotëson kriteret e parashikuara nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës. Një nga detyrimet që ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese mbi detyrimet e Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imuniteteve në procedurën për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të mandatit të deputetit, **është verifikimi nëse mocioni i kërkuar plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70**, me qëllim sipas pikës 4 të po këtij neni vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për të konstatuar pavlefshmërinë apo mbarimin e mandatit të deputetit.

61. Në këtë kuptim, duhet të verifikohet nga pikëpamja formale prej Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet (duke marrë në konsideratë edhe përmbajtjes së vendimit nr. 93 datë 17.05.2016 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese) që a është vetë deputeti ai që ka kryer veprime aktive për të ushtruar një veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, si dhe a ka fituar ai vetë pasuri prej këtyre organeve publike apo jo.

62. Sikurse u shprehëm më sipër, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim, se **Kuvendi vetë nuk ka aftësi të gjykojë mbi meritën nëse mandati i një deputeti ka mbaruar apo është i pavlefshëm**. Në kuptim të pikave 3 dhe 4 të nenit 70 është Gjykata Kushtetuese, ajo që e konstaton një fakt të tillë, por kjo Gjykatë sipas Kushtetutës ka juridiksion vetëm nëse pavlefshmëria apo mbarimi i mandatit të deputetit është pasojë e një shkelja të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë deputeti dhe jo nga personat e lidhur me të.

63. Në të gjithë parashtrimet e bëra në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese ashtu sikurse dhe në vetë mocionin e paraqitur në Kuvend, rezulton e provuar se shkeljet e pretenduar nuk janë kryer nga vetë deputetja znj. Olta Xhaçka, dhe në jurisprudencën e konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese, (vendimi 7/2017 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendim i 93/2016 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese) duhet që Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet të verifikojë

³ Vendim nr. 7 datë 24.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese, fq.14

nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Nga të gjitha provat e shqyrtuara nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, nuk provohet, që deputetja znj. Olta Xhaçka të ketë kryer vetë veprime, të cilat të kenë sjellë për pasojë ushtrimin prej saj të veprimtarisë fitimprurëse, që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të ketë fituar pasuri të këtyre të fundit.

64. Në këto kushte nga pikëpamja formale, Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, si organi që sipas arsyetimit të dhënë me Vendimin nr. 7/2016 të Gjykatës Kushtetuese ka verifikuar edhe plotësimin e kriterëve kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70, dhe provat e paraqitura mund të konsiderohen si shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës ato veprime, të cilat nuk janë kryer nga vetë deputeti.

65. Për të verifikuar pretendimet e parashtruar në këtë kërkesë se veprimtarie shoqërisë në pronësi të bashkëshortit të deputetes znj. Olta Xhaçka konsiderohen si veprime që përfshihen në parashikimet e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës duhet të shtrohen pyetjet

- A po ushtron Deputetja znj. Olta Xhaçka gjatë kohëzgjatjes së mandatit të saj veprimtari fitimprurëse me fonde të buxheti të shtetit, apo që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor?
- A ka fituar Deputetja znj. Olta Xhaçka gjatë kohëzgjatjes së mandatit të saj ndonjë pasuri nga ana e shtetit përfshirë këtu dhe pushtetin vendor?

66. Në përgjigje të këtyre pyetjeve mbështetur në provat e paraqitura bashkangjitur mocionit nuk provohet se:

- i. Deputetja znj. Olta Xhaçka të ketë ushtruar vetë gjatë kohëzgjatjes së mandatit të saj si deputete ndonjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor; dhe
- ii. ajo të ketë fituar ndonjë pasuri publike prej shtetit apo pushtetit vendor.

67. Sa më sipër dhe nga sa konstatohet në provat bashkangjitur kërkesës, nuk rezulton e provuar, se deputetja znj. Olta Xhaçka është në kushtet e parashikimeve të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, sipas rrethanave të faktit rezulton se në rastin konkret, shoqëria “AG TCC” shpk me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike, ka marrë statusin “Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Dreamades Luxyry Suites” pasi ka plotësuar kërkesat ligjore. Sipas këtij vendimi rezulton ndër të tjera se ky subjekt, do të realizojë projektin në një sipërfaqe zhvillimi prej 10.592 m² në ZK 1739 dhe 1481 në Gjilekë, Bashkia Himarë, **sipërfaqe e cila është tërësisht në pronë private.**

68. Po kështu, nga rrethanat e faktit, rezulton e provuar se shoqëria “AG TCC” shpk **nuk është subjekti** që do të përdorë e shfrytëzojë brigjet e detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit (të cilat bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike) por, është subjekti “AG TCC HOTEL MANAGEMENT” Shpk me NUIS M11825022K, si investitori strategjik që do të lidhë

kontratën përkatëse, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti të lejuara me vendimin nr. 3/5, datë 29.03.2021 të KIS të ndryshuar dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë.

69. Në këtë kuptim nuk është shoqëria, kuotat e së cilës zotërohen nga bashkëshorti i deputetes, ajo të cilës me VKM nr. 137, datë 2.3.2022 “Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Dreamades Luxury Suites”, i është njohur e drejta e përdorimit, por një subjekt tjetër, i cili të ketë përfituar të drejtën e përdorimit të bregut të detit dhe plazhit.

70. Pra, në vështrim të urdhërimeve të dispozitës kushtetuese, në rastin konkret *veprimtaria fitimprurëse e bashkëshortit të deputetes nuk rezulton të burojë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor*, pasi jo vetëm nuk ekziston ende asnjë kontratë apo nënkontratë midis shoqërisë “AG.TCC” shpk dhe një institucioni publik, por referuar vendimit të KIS nr. 3/5 datë 29.3.2021, nuk parashikohet të ketë as në të ardhmen, asnjë marrëdhënie kontraktuale nga e cila ky subjekt të përfitojë nga pasuria publike. Këtë marrëdhënie kontraktuale mund ta krijojë shoqëria tjetër “AGTCC HOTEL MANAGEMENT” shpk, e cila është një subjekt tjetër që ka marrëdhënie kontraktore me shoqërinë, ku bashkëshorti i deputetes Znj. Olta Xhaçka zotëron kuota e saj.

71. Edhe vetë kërkuessit në pikën 43 të kërkesës së tyre shprehen se *ka qënë pikërisht deputetja znj. Olta Xhaçka e cila formalisht dhe në aparence shtoi si subjekt, për projektin që tashmë kishte përfituar statusin e investitorit strategjik edhe një subjekt tjetër tregtar* çfarë në vlerësimin e tyre konsiderohet si një veprim fiktiv dhe si i simuluar. Pra, nga vetë kërkuessit pranohet fakti se përfituesi i kontratës për përdorimin e bregut të detit nuk është subjekti tregtar në pronësi të bashkëshortit të deputetes, por një subjekt tjetër, çka sjell për pasojë mos ekzistencën e kushteve të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës që sjellin si pasojë mbarimin e mandatit për shkak të papajtueshmërisë së tij.

72. Veprimet juridikë fiktivë apo të simuluar nuk janë veprime të supozuara se janë të tilla, por janë veprime që sipas nenit 92 të Kodit Civil deklarohen si të tilla nga gjykata. Hyrja në marrëdhënie kontraktore e shoqërisë AG TCC shpk me shoqërinë AG TCC Hotel Management shpk, ku kjo e fundit është përfitues e përdorimit të bregut të detit, është një veprim juridik i vlefshëm për aq kohë sa nuk është konstatuar nga gjykata civil pavlefshmëria absolute e tij për shkak të ekzistencës së fiktivitetit. Shpallja e një veprimi juridiko civil të pavlefshëm për shkak të stimulimit apo fiktivitetit sikurse e parashtrua më sipër është kompetencë lëndore e gjykatave që gjykojnë mosmarrëveshjet civile, dhe jo e Gjykatës Kushtetuese.

73. Pretendimi për fiktivitet të këtij veprimi hyn si objekt në juridiksionin administrativ, ku organet publike të ngarkuara nga ligji për parandalimin e konfliktit të interesit hetojnë një shkak të tillë dhe janë ato që janë pajisur me kompetencën nga ligji për të kërkuar edhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik. Dëshira për të lidhur një kontratë fiktive apo të simuluar, del nga marrëveshja e veçantë e palëve që konsiderohet apo quhet “kundërdeklarim”, pra duhet që të gjitha palët e një veprimi juridik të jenë shprehur se synimi i tyre nuk ka qënë ajo



çka është e dukshme në një veprim juridik, por vullneti i të gjitha palëve pjesëmarrëse në të, ka patur si synim të realizojë një veprim tjetër juridik. Një fakt i tillë nuk sillet si provë nga kërkuesit në këtë gjykim.

74. Pretendimi për konstatimin e pavlefshmërisë apo mbarimit të mandatit për shkak të konfliktit të interesit sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, nuk është një çështje e cila përfshihet në juridiksion e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë nuk mund të pranohet të miratohet një mocion që kërkon vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kur mocioni mbështet në argumenta, se ndodhemi përpara rasteve të parashikuara në pikën 2 të tij. Një pretendim i tillë nuk ka lidhje me pyetjet që shtrohen në kërkesë se përse shoqëritë kanë një pjesë të përbashkët të emrit tregtar, apo pse përdorin adresa emaili të përbashkëta. Nuk mjafton rrethana të tilla për të provuara fiktivitetin e nje veprimi juridiko civil por sipas vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 932, datë 22.06.2000 duhet të provohet deklarimi se ato (palët e veprimit juridik) nuk kanë dashur të kryejnë veprimin juridik që kanë nënshkruar, por ato kanë dëshiruar një veprim tjetër juridik, pasi që të jemi para simulimit duhet të provohet shprehja e vullneti nga të gjitha palët pjesëmarrëse në të.

75. Nga kërkuesit parashtrohet në kërkesën e tyre se nëpërmjet vendimit 3/5 datë 29.03.2021 të KIS subjekti tregtar AG TCC shpk në pronësi të bashkëshortit të deputetes znj. Olta Xhaçka do të përfitonte disa të drejta që sipas arsytimit të tyre konsiderohen veprimtari fitimprurëse me fonde të buxhetit të shtetit si dhe fitim pasurie të paluajtshme nga pronat publike. Tërësisht një interpretim i gabuar, pasi parashikohet për veprime dhe ngjarje që nuk kanë ndodhur por ndoshta pritet të ndodhin në të ardhmen. Sipas arsytimit të bërë në kërkesë arrihet me faktin se nëpërmjet këtij vendimi subjekti tregtar do të mund të përfitonte

➤ *të drejtën e përdorimit për një periudhë 30 vjeçare të bregut të detit.*

Dhënia e një të drejtë nuk është fitim pronësi apo ushtrim veprimtarie fitimprurëse, me fonde të organeve të pushtetit qëndror apo vendor. Është një e drejtë, e cila nuk krijon pasuri nëse nuk ushtrohet. Për gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka nuk provohet se shoqëria AG TCC shpk të ketë ushtruar këtë të drejtë dhe të ketë marrë nëpërmjet kontratës posedimin mbi këtë pronë publike. Sikurse e kemi parashtruar fituesi i të drejtës për lidhjen e kontratës është shoqëria AG TCC Hotel Management shpk.

➤ *mbështetje për kryerjen e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, pra duke kursyer kohë dhe të ardhura, si pasojë e shfrytëzimit të burimeve njerëzore dhe monetare të shtetërore.*

Por pavarësisht këtij pretendimi, rezulton e provuar se subjekti tregtar **shoqëria AG TCC shpk të gjitha lejet zhvillimore i ka marrë para fitimit së statusit investitor strategjik/procedurë e asistuar**, dhe nga pikëpamja faktike nuk ka për të përdorur më administratën shtetërore qoftë nga burimet njerëzore ashtu dhe ato monetare. Por, edhe nëse do ekzistonte një pretendim i tillë, përdorimi i burimeve njerëzore të administratës

publike, është një detyrim i kësaj administrate, kundrejt të gjithë subjekteve të së drejtës, detyrim ky që rrjedh nga Kodi i Procedurave Administrative (neni 10). Organi publik mbarte detyrimin për të siguruar që të gjitha palët dhe persona e përfshirë në procedurën administrative të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai, organi publik, i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën që duhet të ndjekin. Po kështu, administrata shtetërore ofron shërbimet e saj dhe zhvillon procedurën administrative pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Shërbimet e administratës publike ju ofrohen të gjithë subjekteve të së drejtës dhe në asnjë rast ofrimi i një shërbimi të tillë nënkupton përfitim i fondeve publike apo ushtrim veprimtarie fitimprurëse me shtetin. Më këtë logjikë që ngrihet nga grupi i deputetëve kërkuar, çdo deputet që përfiton shërbime nga administrata publike do të konsiderohet në papajtueshmëri për shkak të përfitimeve që ai mund të ketë nga fondet publike.

- *masë mbështetëse për konsolidimin e tokës dhe pronës ku do të zhvillohet projekti, e cila sipas ligjit përkatës, nënkupton përshtatjen dhe ristrukturimin e planifikuar të parcelave të tokës dhe pronës së tyre, pra mund të përfshijë ndryshimin e formës së pronësisë/regjimit juridik dhe shfrytëzimit të tokës etje.*

Edhe ky pretendim i ngritur nuk pasqyron faktin e ushtrimit të veprimtarisë fitimprurëse apo fitimit të pasurive publike nga a e shoqërisë AG TCC shpk. Për më tepër ngjarje të tilla të përmendura në arsyetimin e kërkuarve as kanë gjasa të ndodhin, për shkak se ndërtimi i strukturës hoteliere ka filluar sipas lejeve zhvillimore dhe lejes së ndërtimit përpara datës së miratimit të statusit *investitor strategjik/procedurë e asistuar*. Me Vendimin nr. 5, datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) kësaj shoqërie i është miratuar Leja e Zhvillimit për ndërtimin e një strukture hoteliere në fshatin Gjilekë, Bashkia Himarë. Gjithashtu, me Vendimin nr. 21. Datë 28.07.2020 të KKT shoqërisë AG TCC shpk i është miratuar Leja e Ndërtimit për objektin: “Resort turistik “Dreamades Luxury Sutes”, 1-2.3 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje fshati Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria AG TCC shpk”. Të gjitha sa pretendohen se do të ndodhin janë fakte dhe ngjarje që kanë ndodhur përpara datës 29.03.2021, datë në të cilën me vendimin nr. 3/5 të KIS subjektit tregtar AG TCC i është miratuar statusi *“investitor strategjik/procedurë e asistuar.”*

Përsa i përket pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesë, sikurse është përdormi i infrastrukturës publike, si aksesit në rrjetin energjetik atë të kanalizimeve, rrjetin rrugor apo atë të telekomunikacionit janë një absurditet dhe nonsens juridik. Çdokush, subjekt tregtar apo jo tregtar ka të drejtë të përdorë të gjithë infrastrukturën publike, dhe kjo në asnjë rast nuk konsiderohet veprimtari fitimprurëse me pasuritë e organeve publike të pushtetit qëndror apo vendor, dhe as fitim pasurie nga këto organe. Lidhja me infrastrukturën elektrike dhe atë të kanalizimeve, jo vetëm përpara parashtruar më sipër nuk tregojnë se po ushtrohet veprimtari me pasuritë e organeve publike, por për më tepër është një fakt dhe

ngjarje që ka ndodhur përpara marrjes së statusi investitor strategjik, procedurë e asistuar, pasi janë parakushte për dhënien e lejes së ndërtimit, akt administrativ ky sikurse e parashtruar më sipër ka dalë para miratimit nga KIS i Vendimit Nr. 3/5, datë 29.03.2021. Me këtë logjikë që përdoret në kërkesë, duhet të konsiderohet papajtueshmëri e mandatit të deputetit, për secilin prej deputeteve që përdor infrastrukturën rrugore, rrjetin elektrik, atë të kanalizimeve, pasi me logjikën e kërkuarve një fakt i tillë konsiderohet veprimtari fitimprurëse me pronat e shtetit apo përfitime pasurore nga këto prona.

76. Statusi investitor strategjik procedurë e asistuar nuk jep trajtim preferencial për reduktim të vlerës së TVSH-së për subjektin “shoqëria “AG TCC” shpk me ortak dhe administrator bashkëshortin e deputetes znj. Olta Xhaçka. Sipas nenit 49, pika 3 dhe 4 të Ligjit “Për tatimin e vlerës së shtuar” parashikohet se, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar në masën 6 % aplikohet mbi të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit dhe nuk është një preference kundrejt shoqërisë në fjalë për shkak të statusit “investitor strategjik, procedurë e asistuar”. Tarifa e reduktuar e TVSH-së nuk është pasojë e statusit por është një përfitim që i jepet industrisë së turizmit pavarësisht patjes apo jo të statusit.

77. Në rastin e konkret shtrohet pyetja që a po ushtrohet veprimtari fitimprurëse apo jo. Sipas rrethanave të faktit si nga shoqëria “AG TCC” shpk nuk është duke u ushtruar ndonjë veprimtari fitimprurëse. Struktura hoteliere është në ndërtim, dhe të gjitha pretendimet parashtrohen me faktin nëse në të ardhmen do të ushtrohet ndonjë veprimtari fitimprurëse. Nuk ka akoma ushtrim veprimtarie, gjë e cila e lë pa rast konkret/objekt çështjen në fjalë pa objekt.

78. Si konkluzion sa më sipër rezulton se motivi i vetëm për dhënien e statusit të investitori strategjik, është plotësimi prej subjektit shoqëria “AG TCC” shpk tërësisht i kriterëve të parashikuara nga ligji 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” për marrjen e këtij statusi, si investitor strategjik, me procedure të asistuar në sektorin e turizmit.

79. Sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës sanksionohet parimi, se deputetët nuk mund të kryejnë vetë ndonjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Kurse sipas pikës 4 të po këtij neni: “Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.”

80. Pretendimi i parashtruar nga kërkuarët konsiston në mënyrën sesi dispozitat kushtetuese, neni 70, interpretohet prej tyre. Ne nuk vëmë aspak në diskutim qëllimin e ligjshëm të kushtetutëbërësit në përcaktimin e atyre kushteve, të cilat konsistojnë në papajtueshmëri të mandatit të deputetit. Gjithashtu ne në këto parashtrime nuk po vëmë në diskutim rëndësinë dhe rreptësinë e sanksionit – humbje e mandatit të deputetit- të parashikuar nëse vërtetohet sjellja e parashikuar në nenin 70, por pikërisht duke patur parasysh këtë ndërhyrje theksohet detyrimi primar i organeve zbatuese të dispozitës kushtetuese për të siguruar zbatimin e parashikimeve të pikës 3 nenit të 70 të Kushtetutës në rastin konkret, por edhe vërtetimin në formë apo themel të sjelljes së ndaluar (mbajtja e funksionit publik apo realizimi i përfitimit).



81. Mënyra e parashtruara në mocionin e grupit të deputetëve konsiston në një devijim të parashikimeve të nenit 70 të Kushtetutës, pasi është interpretuar në mënyrë të zgjeruar duke shkëlur qëllimin e ligjvënësit shqiptar, dhe detyrimet e shtetit shqiptarë për të siguruar respektimin e thelbit të nenit 3 të Protokollit Nr 1 të Konventës, sipas së cilit diskualifikimi i mandatit të deputetit duhet të jetë si analiza e fundit e një konflikti interesash dhe se duke konsistuar në një kufizim të drejtash me karakter civil dhe politik ai duhet të jetë i bazuar në një ligj të qartë dhe përtej çdo interpretimi abuzive, i cili do të çonte në mohim të thelbit të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

82. Argumentat e ngritura në këtë mocion në lidhje me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit të znj. Olta Xhaka, janë të përgjithshme dhe lënë hapësira për interpretime të gjera dhe abuzive, të cilat mund të çojnë në cënim të thelbit të së drejtave të garantuara nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës. Gjithashtu, në praktikën e saj Gjykata Kushtetuese nuk ka kryer një interpretim ezaustiv të qëllimit të ligjvënësit dhe sqarimit të situatës në rastin konkret.

83. Kështu si parashtrohet më lart parashikimet e nenit 70/3 i drejtohen “deputetëve” dhe parashtrajnë papajtueshmëri kushtetuese të funksionit të deputetit në lidhje me sjelljen e saj/tij që konsiston në “përfitim nga fonde publike” apo pasuri publike.

84. Kështu, në dispozitat ligjore apo edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nuk ka referenca në lidhje me pajtueshmërinë ose jo të funksionit të deputetit me mbajtjen e funksioneve në sektorin privat nga ana e familjarëve të tyre, ashtu siç vihet re qartë në shumicën e vendeve të Këshillit të Evropës.

85. Kështu, nëse i referohemi parashikimeve të nenit 70 të Kushtetutës, deputeti në mënyrë që të mos humb mandatin e tij duhet të rregulloj sjelljen e tij në mos mbajtjen e funksioneve publike të ndryshme nga ato të anëtarit të Këshillit të Ministrave si dhe të mos përfitoj konkretisht Ai/Ajo nga fondet publik. Por në asnjë dispozitë të parashikimeve kushtetuese apo ligjore nuk ka rregullime, që nga një anë barazojnë sjelljen e familjarit të deputetit, qoftë bashkëshorti në regjim pasuror martesor të bashkuar apo të ndarë, me sjelljen e deputetit të mandatuar nga elektorati i tij (jo se është familjar apo bashkëshort i dikujt) por për atë çka ai përfaqëson personalisht apo nga ana tjetër të mund të cënojnë të drejtën e tij për tu zgjedhur me prezumimin se në të ardhmen potencialisht bashkëshorti i deputetit do mund të ketë përfitime.

86. Nuk po vëmë në diskutim në këtë çështje faktin se kushtetutëbërësi në parashikimet e nenit 70 të Kushtetutës ka vënë kushte në sjelljen e secilit deputet, por në këto parashikime nuk merret parasysh sjellja apo kushtet e një entiteti tjetër të ndryshëm nga deputeti, si në rastin konkret ajo e një shoqërie tregtare, qoftë me ortak/aksionar bashkëshortin e deputetes.

87. Kështu, është evidente se zbatimi i parashikimeve të nenit 70 në subjekte të ndryshme nga deputetet është jo vetëm një interpretim i zgjeruar i qëllimit të kushtetutëbërësit, por ajo në kushtet e mungesës së qartësisë mund të çojë në interpretime arbitrare.

88. Në vazhdimin e interpretimeve të zgjeruara të nenit 70 të Kushtetutës duhet të humbi mandatin edhe deputeti, nëse zona urbane rreth shtëpisë së tij rikualifikohet apo se edhe vetëm rruga që të çon drejt banesës ku ka shtëpinë sistemohet me fonde publike për aq kohë sa vlera e pasurisë së tij do të rritet disa herë si shkak i drejtpërdrejtë nga përdorimi i fondit publik. Njësoj duhet të interpretohet humbja e mandatit edhe nëse do kemi kalim pranë/për në pronën e deputetit të rrjetit të gazit, të fibrave optike, të një rrjeti me eficient elektrik etj. Gjithashtu në interpretime të tilla të zgjeruara do të gjendeshim në rastet kur deputete apo bashkëshortët e tyre mund të jenë aksionar në shoqëri ndërkombëtare të kuotuar në bursë (si shembull mund të jetë Vodafon, Nokia, Siemens apo shoqëri të tjera të kuotuar në burse të cilat janë aktualisht fituese tenderash në Shqipëri) të cilat shoqëri mund të fitojnë tendera publik në Shqipëri dhe ne ndarjet e dividendëve në mënyrë indirekte do të sjellin “përfitim” të deputetit nga fondet publike.

89. Ashtu si Gjykata është shprehur në praktikën e saj çka mësipërm do të mund të justifikohet nën dritën e Konventës nëse ndërhyrja në të drejtën e parashikuar nga Neni 3 i Protokollit 1 do të ishte e përcaktuar në një ligj të qartë, të parashikueshëm, i nevojshëm dhe proporcional.

90. Sa më sipër jemi të mendimit se deputetja znj. Olta Xhacka gjendet në të njëjtat kushte si në rastin e çështjes *Russian Conservative Party of Entrepreneurs and Others k Rusise, nos. 55066/00 and 55638/00, ECHR 2007-...*, ku Gjykata gjeti shkeljen e nenit 3P1 në kushtet kur ankuesi u sanksionua për një sjellje e cila nuk ishte e parashikuar në ligj dhe nuk ishte në kontrollin e tyre pasi kjo ishte e një ndërhyrje jo proporcionale me qëllimin e ligjshëm që përndiqte.

91. Në rastin në shqyrtim rezulton se kriteri formal i kërkuar nga Kushtetuta për të detyruar Kuvendin që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar pavlefshmëri/mbarim të mandatit të deputetes znj. Olta Xhacka nuk ekziston, pasi nuk provohet fakti se prej saj të jetë kryer ndonjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të ketë fituar pasuri të këtyre të fundit. Në këto kushte duke mos qenë përpara ndalimeve të pikës 3 Kuvendi nuk ka kompetencë të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese.

92. Në kuptim sa më sipër Kuvendi ka ushtruar kompetencën e tij sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës dhe në asnjë rast vendimet 83 dhe 84 të tij objekt i kësaj kërkesë nuk janë në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës dhe as me interpretimet e bëra nga Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj në lidhje me parashikimet e pikës 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës.


93. Sa më sipër i kërkojmë Gjykatës Kushtetuese të vendosë për rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Për deputeten

OLTA XHAÇKA

Me prokurë të posaçme nr. repertori 92, Nr. koleksioni 12, datë 07.01.2023

Av. Genci Çifligu



Lista e provave

1. Prokura Nr. 92 Rep., Nr. 12 Kol., datë 07.01.2023;
2. Vendimi Nr. 5, datë 10.06.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT);
3. Vendimi Nr. 21. datë 28.07.2020 të KKT shoqërisë AG TCC shpk i është miratuar Leja e Ndërtimit për objektin : “Resort turistik “Dreamades Luxury Sutes”, 1-2.3 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje fshati Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria AG TCC shpk.”;
4. Vërtetimet e pronesisë së trualiit të ndodhur në fshatin Gjilekë Bashkia Himarë;
5. Vendimi Nr. 3/5, datë 29.03.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES” me subjekt AG TCC me NUIS L52227046H”;
6. Vendimi Nr. 3/9, datë 15.07.2021 të KIS “Për një ndryshim në Vendimin 3/5, datë 29.03.2021 të KIS “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” për projektin e investimit “DREAMADES LUXURY SUITES” me subjekt AG TCC me NUIS L52227046H”;
7. Ekstrakt historik i shoqërisë AG TCC shpk
8. Ekstrakt historik i shoqërisë AG TCC Hotel Management

